



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 750. Akti

Nr. 657 Vendimi
Tiranë, më 28.4.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)	Kryesuese
Xhensila Pine	Relatore
Roland Ilia	Anëtar

në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Jonida Vrana, mori në shqyrtim, çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Periand Teta**, i shortuar si ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b** i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dokumentacionin e administruar nga institucionet shtetërore, si dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes, që i përket statusit ligjor të z. Periand Teta në këtë proces rivlerësimi.

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që bazuar në “Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të përcaktuara në nenin 179/b të Kushtetutës.

2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) në datën 15.6.2021, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit” zhvilloi procedurat e shpërndarjes së çështjeve me short, nga i cili rezultoi se z. Periand Teta do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Roland Ilia, Genta Tafa, Xhensila Pine (relatore e çështjes). Kryesuese e trupit gjykues u caktua komisionere Genta Tafa (Bungo). Anëtarët e trupit gjykues deklaruan mungesën e konfliktit të interesit.

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit, bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, u administrua deklarata e pasurisë, shtojca 2 e ligjit nr. 84/2016, pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, deklaratën për kontrollin e figurës pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, si dhe formularin e vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016.

4. Pas shortimit, z. Periand Teta i është dërguar në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues dhe pyetëtori standard.

5. Në përgjigje të këtij *email*-i, z. Periand Teta deklaroi se nuk njeh asnjë shkak papajtueshmërie apo konflikt interesi për trupin gjykues dhe përcolli në Komision në rrugë elektronike përgjigjet e pyetëtorit standard dhe dokumentacionin shoqërues. Komisioni, pas këtij hapi procedural, vlerësoi të verifikojë së pari statusin ligjor të z. Periand Teta.

6. Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 8.3.2023, i kërkoi informacion Këshillit të Lartë Gjyqësor në lidhje me marrëdhëniet e punësimit, kohën, formën dhe largimin nga ushtrimi i funksionit të ndihmësit ligjor të z. Periand Teta pranë Gjykatës së Lartë.

7. Këshilli i Lartë Gjyqësor, me shkresën nr. *** prot., datë 17.3.2023, paraqiti:

- i. urdhrin e Kryetarit të Gjykatës së Lartë nr. ***, datë 3.2.2014, “Për emërimin në detyrë të z. Periand Teta”,
- ii. urdhrin nr. ***, datë 25.7.2017, “Për përfundimin e kontratës së punësimit me afat të z. Periand Teta me Gjykatën e Lartë dhe lirim të tij nga detyra e ndihmësit ligjor”;
- iii. kontratën individuale të punës nr. *** prot., datë 3.2.2014, të punëdhënësit, Gjykatës së Lartë, dhe punëmarrësit, z. Periand Teta;
- iv. shkresën nr. *** prot., datë 19.7.2017, ku z. Periand Teta kërkon reagimin e Gjykatës së Lartë lidhur me marrëdhëniet e tij të punës.

8. Komisioni kërkoi pranë Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë informacion mbi pagesat e marra nga ndihmësi ligjor Periand Teta.

9. Gjykata e Lartë, me shkresën nr. *** prot., datë 29.3.2023, informoi se z. Periand Teta kishte përfituar të ardhura nga paga *neto* si ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë për periudhën 3.2.2014 – 25.7.2016 dhe se nga muaji gusht i vitit 2016 nuk kishte përfituar më të ardhura nga paga si ndihmës ligjor.

10. Komisioni, në datën 18.4.2023, me anë të postës elektronike vendosi të njoftojë z. Periand Teta: (i) me konkluzionin e arritur nga ana e trupit gjykues lidhur me statusin ligjor të tij; (ii) me korrespondencën që ka shërbyer për këtë konkluzion në referencë të nenit 22/b të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, me dërgimin nëpërmjet *email*-it të skanimit të të gjithë komunikimit me institucionet gjatë kësaj periudhe; (iii) me të drejtën e tij për të sjellë shpjegime lidhur me konkluzionin e Komisionit dhe të drejtën e tij për t’u shprehur në seancë dëgjimore publike.

11. Z. Periand Teta njoftoi Komisionin se nuk do të paraqiste parashtrësia lidhur me konkluzionin e arritur nga trupi gjykues dhe nuk dëshironte të paraqitej në seancën publike.

II. ARSYET E PËRFUNDIMIT TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

Verifikimi i statusit ligjor të z. Periand Teta

12. Nga rrethanat e faktit Komisioni, pasi kreu verifikimin e natyrës specifike të statusit që gëzon dhe cilësimin e saktë të situatës ligjore në të cilën z. Periand Teta ndodhet, vlerësoi se z. Periand Teta, bazuar në nenin 179/b, pika 4 e Kushtetutës, nuk bënte pjesë në kategorinë e subjekteve të rivlerësimit *ex officio* për sa vijon:

13. Rezultoi e provuar se z. Periand Teta kishte ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë dhe kishte përfituar të ardhura nga kjo detyrë nga data 3.2.2014¹ deri më 18.7.2016 dhe duke filluar nga muaji gusht i vitit 2016 konfirmohej se ai nuk kishte përfituar të ardhura nga paga si ndihmës ligjor.

14. Në datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, z. Periand Teta nuk e ushtronte detyrën e ndihmësit ligjor dhe as paguhej për këtë detyrë.

15. Trupi gjykues arsyeton se marrëdhënia e punës, e formalizuar me kontratën e punës hartuar mes palëve, kishte disa elemente thelbësore të saj, që përbënin edhe thelbin e kontratës së punës, të tilla si vendi e pozicioni/detyra e punës, si dhe paga e punëmarrësit për atë vend e pozicion pune.

16. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se në datën 18.7.2016, kontrata e punës si këshilltar ligjor e z. Periand Teta konsiderohej e zgjidhur për sa kishin ndryshuar disa nga elementet thelbësore të kësaj kontrate si detyra të cilën ai nuk e ushtronte më efektivisht, si dhe paga, të cilën nuk e përfitonte më lidhur me këtë detyrë.

17. Me shkresën nr. *** prot., datë 19.7.2017, z. Periand Teta iu drejtua Kryetarit të Gjykatës së Lartë si vijon: “Unë, i nënshkruari Periand Teta, ushtroj funksionin e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë nga data 3.2.2014 dhe në vazhdim. Jam pezulluar nga data 20.7.2016, por nga ana e institucionit të Gjykatës së Lartë nuk ka asnjë vendimmarrje në lidhje me vijueshmërinë e marrëdhënies së punës. Ju sjell në vëmendje se duhet të shmangen veprimet, të cilat cenojnë të drejtat e punëmarrësit, si dhe veprimet e punëdhënësit duhet të jenë të bazuara në ligj për të mos tejkaluar të drejtën e tyre gjatë ushtrimit të të drejtave dhe detyrimeve gjatë marrëdhënies së punës”.

¹ Urdhri nr. ***, datë 3.2.2014, “Për emërimin në detyrë”, i Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

18. Në përgjigje të kësaj shkrese Kryetari i Gjykatës së Lartë, nëpërmjet urdhrit nr. ***, datë 25.7.2017, njoftoi z. Periand Teta mbi përfundimin e kontratës së punësimit me Gjykatën e Lartë dhe lirim të tij nga detyra e ndihmësit ligjor. Trupi gjykues vlerëson se efektet financiare të këtij urdhri datonin nga data 18.7.2016, kohë kur ai nuk paguhej më si ndihmës ligjor.

19. Në analizë të fakteve, provave dhe kuadrit ligjor, z. Periand Teta ka dhënë pëlqimin në mënyrë të heshtur për ndërprerjen e kontratës së tij të punës lidhur me ushtrimin e detyrës së ndihmësit ligjor, duke mos e ankimuar atë në gjykatë. Shprehja e vullnetit në këtë rast nëpërmjet mungesës së kundërshtimit në rrugë gjyqësore konsiderohet nga trupi gjykues se është shprehje e pëlqimit të heshtur dhe dakordësimi i tij lidhur me këtë procedurë.

20. Pavarësisht të drejtës ligjore të përmendur nga vetë z. Periand Teta në shkresën nr. *** prot., datë 19.7.2017, drejtuar Kryetarit të Gjykatës së Lartë, ai nuk ndërmori asnjë hap ligjor lidhur me sa referonte te kërkesa e tij mbi veprimet, të cilat cenonin të drejtat e punëmarrësit, veprimet e punëdhënësit dhe respektimin e të drejtave dhe detyrimeve gjatë marrëdhënies së punës.

21. Për më tepër, z. Periand Teta iu drejtua ILDKPKI-së me kërkesën nr. *** prot., datë 1.8.2017, duke parashtruar kërkesën për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit vullnetarisht si ish-këshilltar, pasi plotësonte kriterin trevjeçar të punësimit si ndihmës ligjor.

22. Trupi gjykues vlerëson se subjekte të ligjit nr. 84/2016 janë ato të parashikuara në nenin 179/b/4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë sipas të cilit *të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë së Përgjithshme do të rivlerësohen ex officio*, të cilët i nënshtrohen vlerësimit *ex officio*.

23. Duke vlerësuar faktet ligjore Komisioni ka vlerësuar se z. Periand Teta nuk ishte subjekt rivlerësimi i ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", për sa kohë në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji ai nuk e ushtronte efektivisht detyrën e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

24. Lidhur me kërkesën e z. Periand Teta se dëshironte t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit vullnetarisht si ish-këshilltar, Komisioni ka vlerësuar rrethanat faktiko-ligjore si vijon:

25. Në pikën 4 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka një parashikim të posaçëm: "*Të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë së Përgjithshme do të rivlerësohen ex officio*".

26. Në paragrafin e dytë të pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është rregulluar në mënyrë specifike se *procesit të rivlerësimit mund t'i nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish-gjyqtarët, ish-prokurorët, ish-këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën 3 vjet.*

27. Paragrafi i parë dhe i dytë i pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë rregullojnë dy raste të ndryshme, ndërsa në pikat 3 dhe 4, paragrafi i parë i nenit 179/b, parashikohen rregulla të përgjithshme për subjektet *ex officio*, në parashikimin në vijim, konkretisht në paragrafin e dytë të nenit 4, nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është parashikuar një rregullim i posaçëm që u kundërdrejtohet një grupi tjetër të caktuar subjektësh, pikërisht ish-gjyqtarëve, ish-prokurorëve dhe ish-këshilltarëve ligjorë.

28. Më konkretisht, në analizë të paragrafit të dytë të pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *se çdo ish-gjyqtar, ish-prokuror dhe ish-këshilltar ligjor që bën kërkesë, plotëson kriteret sipas ligjit dhe që ka punuar në këto pozicione të paktën 3 vjet del qartë dhe pa lënë vend për interpretim të zgjeruar të rrethit të subjekteve që do të përfshihen në kategorinë e ish-gjyqtarëve, ish-prokurorëve dhe ish-këshilltarëve ligjorë.* Terminologjia “ish” nënkupton subjektet që me hyrjen e ndryshimeve kushtetuese në fuqi cilësoheshin si ish-gjyqtarë, ish-prokurorë dhe ish-këshilltarë, që kishin punuar në këto pozicione të paktën 3 vjet.

29. Komisioni, pasi ka kërkuar informacion pranë Gjykatës së Lartë lidhur me pagesat e marra nga ndihmësi ligjor dhe me shkresën nr. *** prot., datë 29.3.2023, të Gjykatës së Lartë, është informuar se z. Periand Teta ka përfituar të ardhurat nga paga *neto* si ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë për periudhën 3.2.2014 – 25.7.2016 dhe nga gushti i vitit 2016 nuk ka përfituar më të ardhura nga paga si ndihmës ligjor.

30. Sa më sipër, Komisioni çmoi se z. Periand Teta nuk gëzonte as statusin e ish-këshilltarit ligjor, për sa kohë nuk provohej se kishte punuar në këtë pozicion për 3 vjet, (sipas dokumentacionit ligjor periudha efektive e punësimit rezultonte nga data 3.2.2014 deri më 18.7.2016).

31. Në këto kushte, trupi gjykues arriti në përfundimin se z. Periand Teta nuk bën pjesë as në kategorinë e subjekteve të rivlerësimit *ex officio* dhe as nuk mund të trajtohet si ish-këshilltar ligjor duke arritur në konkluzionin se ai nuk ishte objekt i veprimit të nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë.

32. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se ndodhet në kushtet e ndërprerjes së procesit të rivlerësimit për z. Periand Teta, pa një vendim përfundimtar për çështjen, sipas përcaktimeve të nenit 95 të Kodit të Procedurave Administrative, i cili parashikon se: *“Procedimi administrativ përfundon kur organi administrativ kompetent për marrjen e vendimit përfundimtar zbulon se objekti për të cilin kishte filluar procedimi ose qëllimi i vendimit është bërë i pamundur”*.

33. Për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e të drejtës për t’u dëgjuar, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe në orientimin e dhënë nga Kolegji i Posaçëm i Apelit me vendimin nr. 17/2019 (JR), trupi gjykues verifikoi rastet përjashtimore të zbatimit të dispozitës mbi thirrjen në seancë dëgjimore, përcaktuar në mënyrë shteruese në nenin 89 të Kodit të Procedurave Administrative.

34. Trupi gjykues arriti në përfundimin se plotësoheshin rastet përjashtimore të parashikuara në nenin 89 të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilave procedura administrative mund të mbyllet pa i dhënë mundësinë për t’u dëgjuar, për sa kohe ai e kishte shprehur vullnetin e tij duke deklaruar se nuk do të paraqiste

parashtrës dhe nuk do të paraqitej në seancën publike dhe, për rrjedhojë, mosmbajtja e seancës dëgjimore nuk do të ishte në kundërshtim me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

35. Zgjedhja nga Komisioni në këtë rast bëhet për të arritur objektivin e caktuar me ligj të kryerjes së procesit të rivlerësimit në përputhje me parimet e përgjithshme të legjislacionit në fuqi, si dhe nuk përbën shmangie nga vendimet e mëparshme të marra nga Komisioni.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin 179/b, pika 4 e Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, dispozitat kalimtare të ligjit nr. 96/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë përfundimin e procesit të rivlerësimit, pa një vendim përfundimtar për z. Periand Teta.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të këtij vendimi.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më 28.4.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Genta Tafa (BUNGO)

Kryesuese

Xhensila PINE

Relator

Roland ILIA

Anëtar

Sekretare gjyqësore

Jonida Vrana